



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 595  
Datë: 11/3/2019

Rektori i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 25 dhe 28, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, merr këtë:

**V E N D I M**


- I. Personeli akademik i Universitetit të Prishtinës, që ushtron mandat menaxherial në nivel të njësisë akademike apo të Universitetit të Prishtinës, obligohen që të gjitha aktivitetet e mësimdhënies (ligjërata dhe ushtrime), të parapara gjatë ditëve të punës dhe brenda orarit të rregullt të punës, t'i zhvendosin pas orës 16:00 ose ditëve të fundjavës.
- II. Përgjegjës për rregullimin e orarit të mësimdhënies do të jenë menaxhmentet e njësive akademike në koordinim me profesorët të cilët bartin pozita menaxheriale si në pikën I, të këtij vendimi.
- III. Ky vendim do të zbatohet nga semestri veror i vitit akademik 2018/19 dhe do të vlejë për kohë të pakufizuar.

**Arsyetim**

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të punës për strukturat menaxhuese në nivel të njësive akademike dhe në nivel të Universitetit të Prishtinës dhe duke pasur parasysh se orët e mësimt (ligjëratat dhe ushtrimet) të cilat mbahen nga personeli akademik që bartë pozitë menaxhuese, kompensohet si mbinormë, Rektori i Universitetit të Prishtinës duke u mbështetur në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 25 dhe 28 të Statutit të UP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Arkivit të UP-së;
2. Rektorit;
3. Prorektorëve;
4. Dekanëve të njësive akademike;
5. Sekretarit të Përgjithshëm;
6. Zyrës për çështje akademike dhe
7. Për publikim në Ueb-faqe të UP-së.



Prof. Dr. Marjan Dema – Rektor i UP

Rektor i Universitetit të Prishtinës